

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	10.01.2024	Përpara aplikimit kam disa pyetje për të cilat kërkoj informacion mbi procedurën: 1) A mund të bashkohen dy e më shumë vendime kompesimi bashke e të paraqiten me një kërkesë të vetme, apo për çdo vendim duhet të paraqitet kërkesë më vehte? 2) Nese pasuria e cituar për parablerje në vendim mund të kthehet në kompensim dhe a duhet kjo të shprehet nga subjekti përfitues me deklaratë	16.01.2024	Aktualisht, ATP ka publikuar regjistrin e vendimeve të cilat iu kanë njohur subjekteve të shpronësuar të drejtën e kompensimit, si dhe vlerësimet financiare të vendimeve për vitet 1993- 2013. Në kërkesën tuaj nuk keni vendosur të dhëna në lidhje me numrin, datën dhe subjektin e shpronësuar në mënyrë që t'ju informojmë nëse figuron apo jo i vlerësuar financiarisht. Sqarojme se kur subjekti disponon një vendim përfundimtar të vlerësuar financiarisht, kërkesa për kompensim paraqitet nga subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ose përfaqësuesi	E Plote	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		<p>noteriale apo mjafton të shkruhet në kërkesë</p> <p>3) Në deklaratën noteriale ku subjekti i shpronësuar deklaron nëse ka përfituar nga dispozitat e ndarjes së tokës bujqësore a bëhet fjalë vetëm për ligjin 7501?</p> <p>4) A mundet që deklaratat noteriale të trashëgimtarëve të permbliken në një të vetme, ku të gjithë firmosin bashkërisht?</p> <p>5) Vërtetimi nga ZVRPP për gjendjen juridike të pronës është nxjerrë në vitin 2019. A është ky vërtetim i vlefshëm për aplikim apo duhet vërtetim i tre muajve të fundit?</p>		<p>me prokurë, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas formularit tip të miratuar me VKM-ne nr. 1114/2020 dhe është pjesë përbërëse e tij vetëm on-line, nëpërmjet portalit e- albania.</p> <p>Në lidhje me pyetjet tuaja ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Pyetja 1- Për sejcilin vendim përfundimtar që dispononi kërkesa për kompensim duhet të paraqitet më vehte nëpërmjet portalit e-Albania.</p> <p>Pyetja 2- Referuar ligjit 133/2015 "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave", i ndryshuar neni 22, është parashikuar se: "<i>Për pronat e paluajtshme, të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuar kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen. Subjektet e shpronësuar kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta e parablerjes përkundrejt kompensimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, brenda një afati 1-vjeçar nga publikimi i regjistrimit, sipas këtij ligji. Ky afat është prekluziv</i>".</p> <p>Pyetja 3 dhe 4 -Referuar formularit tip bashkëlidhur VKM-se 223/2016, të ndryshuar, një nga dokumentat që duhet të paraqiten është: Deklaratë</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>noteriale nga subjektit i shpronësuar/ përfaqësuesi me prokurë i të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, ku të deklarohet nëse: a) vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi financiar i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, b) nëse këto subjekte kanë qenë apo jo të paditur apo persona të tretë në proceset gjyqësore me objekt ankimimin e vendimit për të cilin aplikojnë,</p> <p>c) nëse për vendimin për të cilin aplikohet kanë përfituar ose jo kompensim financiar apo fizik,</p> <p>d) nëse kanë përfituar apo jo nga ligji nr. 7501/1991 "Për tokën" apo akte të tjera të dala në zbatim të tij;</p> <p>Pyetja 5 - Gjithashtu referuar formularit tip si dokumentacion i nevojshëm për aplikim është edhe konfirmim nga ASHK përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (pervec rasteve të tokave të përmbytura nga liqenet apo hidrocentralet dhe vendimeve me vlerë). Gjendja juridike duhet të jetë aktuale, pra e afërt me momentin e aplikimit.</p> <p>Ne zbatim të Ligjit Nr. I07/2021 "Për Bashkeqeverisjen", Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020" , Urdhrit Nr. 556, date 17.12.2019 "Për caktimin e personave të autorizuar që do të perdorin Portalin Qeveritar e-Albania për shërbimet online, prej datës 01.01.2020" të Ministrit të Drejtësisë, ju informojme se:</p> <p>Për të marrë shërbimin e kërkuar elektronikisht ju duhet të aplikoni në portalin e-albania.</p>		
02	10.01.2024	<p>1.A ka informacione , dokumenta , harta , regjistra , në Arkivin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave në të cilat vërtetohen gjurmët e pronësisë për të ndierin X Y. Nëse po , lutem më mundësoni një kopje.</p> <p>2.A ka individë të tjerë të cilët janë paraqitur në emër e për llogari të subjektit X Y me qëllim perfitimi , kthimi fizik pronash dhe nëse po , lutem më mundësoni një kopje të kërkeses së tyre.</p> <p>3.Cila është metoda ligjore për të kërkuar kthimin e pronave të babait tim.? Shikuar rastin lutem më mundësoni një listë ligjesh</p>	12.01.2024	<p>Nga verifikimet e kryera pranë Arkivës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe Drejtorisë së Trajtimit ë Kërkesave për Njohje Pronesie, nuk rezulton të jetë depozituar dosje apo praktikë në emer te subjektit të pretenduar si i shpronësuar X Y, për prona të ndodhura në Qarkun Kukës, referuar të dhënave në kërkesën suaj.</p> <p>Në bazë të ligjit nr. 133/2015, "Për Trajtimin e Prones dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave", neni 27, pika 1, është përcaktuar se: "ATP-ja shqyrton kërkesat e paraqitura dhe që janë të</p>	E Plote	Nuk ka

		<p>ku mund të mbështetem si dhe listën e dokumentave ligjor qe duhen pregaditur..</p>		<p><i>patrajtuara, sipas dispozitave të këtij ligji.</i> <u><i>Pas hvrjes në fuqi të ketij ligji, subjekteve të interesuara u caktohet një afat prekluziv prej 90 ditësh për aplikimin në lidhje me njohjen e pronesisë. Ky afat nuk mund të zgjatet dhe as të rivendoset në afat nga gjykata apo ndonjë organ tjetër administrativ "</i></u></p> <p>Në keto rrethana, ju bëjmë me dije se deri në datën 23.05.2016, trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar kanë patur të drejtë të paraqisnin kërkesën për njohjen dhe kompensimin e pronës, në zbatim të ligjit nr. 133/2015 "Per Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave".</p> <p>Sa me sipër, Agjencia e Trajtimit të Pronave është në pamundësi ligjore të trajtojë kërkesën tuaj.</p>		
--	--	---	--	---	--	--